



Funded by
the European Union

Performanca dhe Mangësitë: Trajtimi Institucional i Dhunës në Familje në 2025

Mars 2026



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE



Funded by
the European Union

Performanca dhe Mangësitë: Trajtimi Institucional i Dhunës në Familje në 2025

Mars 2026

Autorë:

Liridon Salihi,
Elona Kurti

Kontribues:

Anesa Kashtanjeva Isufi
Arbresha Sherifi
Astrit Muhaxhiri
Fahri Drenica
Fatjona Musliu
Ilir Koçani
Lorik Kabashi

Mars 2026

Projekti me titull: "Fuqizimi i Rolit të Shoqërisë Civile në Luftimin e Pabarazisë Sociale dhe Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë" financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

* Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Përmbajtja

1. Hyrje.....	04
2. Metodologjia.....	05
3. Legjislacioni i Kosovës për Dhunën në Familje: Korniza Aktuale dhe Mbrojtja ..	06
4. Raportimi i Rasteve të Dhunës në Familje tek Policia e Kosovës.....	09
4.1 Shpërndarja rajonale e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës për dhunë në familje.....	09
4.2 Dimensioni gjinor në rastet e dhunës në familje.....	11
4.3 Roli i marrëdhënieve familjare në dinamikën e dhunës në familje.....	13
4.4 Analiza demografike e viktimave dhe të dyshuarve për dhunë në familje.....	16
5. Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje nga Prokurori i Shtetit.....	17
5.1 Kallëzimet dhe Aktakuzat Penale: Iniciativa për Drejtësi dhe Mbrojtje.....	18
5.2 Ndarja rajonale e aktakuzave për dhunë në familje.....	19
5.3 Vlerësimi i performancës së Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje: efikasiteti dhe sfidat.....	20
» Përqindja e Shkallës së Zgjidhjes 2025.....	20
» Raporti i Qarkullimit të Lëndëve në vitin 2025.....	21
» Koha e Zgjidhjes për vitin 2025.....	21
6. Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje në Procedurën Penale nga Gjykatat Themelore në Kosovë Gjatë Vitit 2025.....	22
» Përqindja e Shkallës së Zgjidhjes për vitin 2025.....	23
» Raporti i Qarkullimit të Lëndëve në vitin 2025.....	24
» Koha e Zgjidhjes.....	24
6.1 Analiza e të dhënave mbi vendimet penale përfundimtare në rastet e dhunës në familje nga Gjykatat Themelore në Kosovë.....	25
6.3 Karakteristikat e rasteve të dhunës në familje sipas të dhënave të monitorimit.....	30
7. Gjetjet dhe Rekomandimet.....	32

1. Hyrje

Fenomeni i dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë mbetet një nga shqetësimet e vazhdueshme si për qytetarët ashtu edhe për institucionet publike të mandatuara për ta parandaluar dhe luftuar këtë fenomen. Pavarësisht veprimeve konkrete për parandalimin e këtij fenomeni, sfidat e institucioneve dhe efikasiteti jo i kënaqshëm gjyqësor në trajtimin e rasteve të kësaj natyre, pasqyrojnë domosdoshmërinë e rritjes së ndërgjegjësimit shoqëror mbi pasojat negative të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe kërkimin e llogaridhënies nga policia, prokuroria dhe gjykatat në lidhje me trajtimin institucional të rasteve të tilla.

Bazuar në Raportin e Komisionit Evropian (KE) të vitit 2025, Kosova vlerësohet të ketë një kornizë të konsoliduar ligjore dhe institucionale për barazinë gjinore dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore, por zbatimimi i saj ende mbetet i mangët. Aty theksohet se gratë vazhdojnë të përballen me forma të shumta diskriminimi, ndërsa dhuna me bazë gjinore mbetet fenomen i shpeshtë, ku dhuna në familje vazhdon të jetë forma e saj më e përhapur.¹

Ky raport, i hartuar në kuadër të projektit me titull “Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftimin e pabarazisë sociale dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë”, i financuar nga Bashkimi Evropian, paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të trajtimit institucional të rasteve të dhunës në familje për vitin 2025. Raporti vlerëson qasjen institucionale të Policisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe Gjykatave në procesin e raportimit, ndjekjes penale dhe gjyqimit të rasteve të dhunës në familje.

Dhuna me bazë gjinore shfaqet në shumë forma, duke përfshirë dhunën seksuale, fizike, emocionale ose psikologjike, dhe socio-ekonomike kundër grave. Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat e analizuar dhe të prezantuara janë vetëm për dhunën në familje me fokus në gjininë.

Pjesa e parë e raportit trajton kornizën aktuale ligjore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke elaboruar bazën kryesore për analizën e mëvonshme të çështjeve që ndërlidhen me trajtimin institucional të rasteve të dhunës në familje.

Më pas, kapitulli i parë analizon të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës (PK), duke u përqendruar në shpërndarjen rajonale të rasteve të raportuara, trendet demografike, raportin e palëve procedurale dhe përfaqësimin gjinor. Kapitulli i dytë vlerëson performancën e Prokurorive Themelore duke shqyrtuar përpunimin e kallëzimeve penale dhe ngritjen e aktakuzave në rastet e dhunës në familje. Kapitulli i tretë fokusohet në Gjykatat Themelore dhe ofron një analizë gjithëpërfshirëse të rolit të tyre, duke u mbështetur në dy burime kryesore të të dhënave: monitorimin e rregullt të gjykatave nga zyrtarët monitorues të angazhuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), dhe analizën e detajuar të të dhënave të ofruara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Ky kapitull shqyrton gjithashtu Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2025 për Publikimin e Vendimeve Gjyqësore, përmes të cilit KGJK ka ndaluar publikimin e vendimeve në çështjet penale që përfshijnë vepra penale të kryera brenda marrëdhënieve familjare.

Në pjesën e fundit, raporti ofron një sërë rekomandimesh të detajuara dhe të bazuara në prova për përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe mbrojtjen e viktimave.

1 Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën, 2025, f. 37-38., i qasshëm në: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/127563ea-4c03-44a4-b56c-2d569afd86a5_en?filename=kosovo-report-2025.pdf

2. Metodologjia

Ky raport vlerësimi mbulon periudhën nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2025, dhe është përpiluar bazuar në të dhënat e marra nga dy burime kryesore: të dhënat zyrtare nga institucionet kryesore të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përkatësisht Policia e Kosovës (PK), Prokurori i Shtetit (PSh) dhe KGJK-ja, dhe burimi i dytë janë të dhënat e mbledhura përmes monitorimit sistematik të gjykatave nga GLPS. Të dhënat nga PK, PSh dhe KGJK u mbledhën dhe u analizuan për tërë vitin 2025, ndërsa të dhënat e monitorimit të gjykatave mbulojnë periudhën maj-dhjetor 2025.

Të dhënat zyrtare nga PK, PSh dhe KGJK përfshijnë statistika mbi raportet, aktakuzat dhe lëndët e gjykuara në lidhje me rastet e dhunës në familje. Nga baza e të dhënave e KGJK-së, ky raport ka nxjerrë numrin e lëndëve të reja të pranuar brenda vitit, numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura, si dhe llojet e vendimeve dhe dënimeve. Pjesa tjetër e të dhënave në lidhje me gjykatat e Kosovës është nxjerrë nga monitorimi i lëndëve nga GLPS në gjykata. Analiza dhe krahasimi i të dhënave nga sistemet prokuroriale dhe gjyqësore është kryer në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), përmes treguesve të tillë si: përqindja e Shkallës së Zgjidhjes së Lëndëve, Raporti i Qarkullimit të Lëndëve dhe Koha e Zgjidhjes së tyre. Kjo metodologji është ndjekur edhe në raportin e mëparshëm të publikuar nga GLPS për periudhën korrik 2023-qershor 2024, në kuadër të iniciativës JUST REACT.²

Ndërkohë, të dhënat e marra përmes monitorimit sistematik të shtatë Gjykatave Themelore u përdorën për ta vlerësuar efikasitetin e gjyqësorit në caktimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore në rastet e dhunës në familje. Këtu gjithashtu u identifikuan shkeljet procedurale gjatë periudhës së monitorimit. Për këtë raport, u monitoruan gjithsej 830 seanca gjyqësore dhe u analizuan të dhëna të përzgjedhura për 568 vendime të marra nga KGJK-ja. Rastet gjyqësore u monitoruan sipas konfidencialitetit të rreptë të procedurës dhe rregullave të përcaktuara në Memorandumin e Bashkëpunimit mes KGJK-së dhe GLPS-së.³ Si pjesë e iniciativës Just React, GLPS ka hartuar një Udhëzues për Monitorim të Ndjeshëm Gjinator të Gjykatave në Rastet e Dhunës në Baza Gjimore.⁴ Ky udhëzues shërben si referencë kyçe për praktikën e monitorimit me ndjeshmëri gjimore dhe është dedikuar për studiuesit, monitoruesit e projekteve dhe akterët e tjerë të përfshirë në mbikëqyrjen e procedurave gjyqësore.

2 Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje: Korrik 2023 – Qershor 2024, Nëntor 2025, në dispozicion në: <https://legalpoliticalstudies.org/institutional-treatment-of-domestic-violence-cases-july-2023-june-2024/>

3 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Memorandum Bashkëpunimi midis: Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), 2025, në dispozicion në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/29228_Memorandum%20i%20bashk%C3%ABpunimit%20nd%C3%ABrmjet%20KGJK%20dhe%20GLPS_ALB.pdf

4 GLPS, Udhëzues për Monitorim të Ndjeshëm Gjinator të Gjykatave në Rastet e Dhunës në Baza Gjimore, i qasshëm në: <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2025/12/GLPS-Manual-on-Gender-Sensitive-Court-Monitoring.pdf>

3. Legjislacioni i Kosovës për Dhunën në Familje: Korniza Aktuale dhe Mbrojtja

Në kontekstin e zhvillimit të vazhdueshëm të kornizës së saj institucionale dhe ligjore, Kosova ka bërë përparim të dukshëm gjatë 25 viteve të fundit në miratimin e legjislacionit që synon parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, dhe dhunës me bazë gjinore në përgjithësi. Ky legjislacion përcakton gjithashtu përgjegjësitë e qytetarëve dhe institucioneve për t'i mbrojtur viktimat dhe viktimat e mundshme nga forma të ndryshme të dhunës, duke përfshirë dhunën në familje ose dhunën ndaj grave, e cila mbetet forma më e përhapur e dhunës me bazë gjinore.

Korniza ligjore vendore lidhur me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje është si më poshtë:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22, nëntë (9) instrumente ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj;

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj;

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare;

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese;

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074 dhe Ligji Nr. 08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal Nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës

Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale dhe Ligji Nr. 08/L-187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale Nr. 08/L-032

Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore

Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës

Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (Zyra e Prokurorit)

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (Agjencia për Barazi Gjinore)

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (Agjencia për Barazi Gjinore)

Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë.

Si akti më i lartë juridik, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (tutje referuar si: Kushtetuta) në kapitullin mbi të drejtat dhe liritë, ndër dispozitatë tjera promovon parime dhe garanci kushtetuese përmes të cilave garantohet e drejta për jetë dhe respektimi i integritetit fizik dhe psikologjik të çdo qytetari, duke kërkuar që e njëjta të imponohet dhe të kufizohet vetëm me ligj. Për t'i respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, Kushtetuta parashikon që, në raste konflikti, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare mbizotërojnë mbi dispozitatë e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Brenda kësaj kornize, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Amendamentin Nr. 26 të Kushtetutës në vitin 2020, duke njohur Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) midis instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Meqenëse dhuna në familje në vendin tonë është kryesisht e bazuar në gjini, ku gratë përbëjnë shumicën e viktimave, përfshirja e Konventës së Stambollit në Kushtetutën tonë përfaqëson një hap të rëndësishëm dhe një përgjigje direkte ndaj këtij fenomeni, sepse ky instrument ndërkombëtar përqendrohet në dhunën si shkelje e të drejtave të njeriut dhe formë të diskriminimit gjinor, veçanërisht ndaj grave.⁵

Për mbrojtjen e dinjitetit të viktimave të dhunës fizike, psikologjike ose ekonomike dhe sigurimin e përgjegjësisë penale të kryesve të veprës, vepra penale e dhunës në familje është përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (tutje referuar si: Kodi), që është në fuqi që nga prilli i vitit 2019. Ndërkohë, me plotësimin dhe ndryshimin e Kodit në vitin 2023, u bënë disa ndryshime të rëndësishme në lidhje me aspektin e ndjekjes penale në rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në jetën publike. Kjo e fundit tani është përcaktuar edhe si vepër penale: "Kushdo që me qëllim të frikësimit ose detyrimit për të vepruar kundër vullnetit të tyre, me dashje ushtron dhunë fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike, në formë të drejtpërdrejtë apo indirekte, ndaj grave që ushtrjnë funksione publike ose kandidatë për ushtrimin e funksioneve publike dënohet me gjobë dhe me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet."⁶

Edhe pse sanksioni penal i parashikuar kundër kryesve të dhunës në familje është dënimi maksimal me 3 vjet burgim, ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal në vitin 2023 solli disa risi në dënimet plotësuese që Gjykatat mund të vendosin ndaj atyre që shpallen fajtorë, të tilla si: ndalimi i blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, asetëve publike apo licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet; ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo formë tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislati në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet; ndalimi i kandidimit për pozita publike për tre (3) deri në dhjetë (10) vjet dhe ndalimi i punësimit në sektorin publik.

Për t'i adresuar më mirë objektivat dhe kërkesat e Konventës së Stambollit, dhe për të marrë masa parandaluese kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, Kosova miratoi Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë gjinore në vitin 2023. Ky ligj prezanton masa të reja shtesë që synojnë të kontribuojnë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, të promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, si dhe të ndërtojnë mekanizmat e nevojshëm për të ofruar mbështetje për viktimat e të gjitha formave të dhunës.⁷

5 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), Neni 3, e qasshme në: <https://rm.coe.int/168008482e>

6 Ligji nr. 08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84232>

7 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, 2023, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

Ky ligj përcakton qartë edhe fushëveprimin e vet duke përcaktuar detyrimin e institucioneve publike, private, shoqërisë civile dhe profesionistëve të tjerë për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Ndryshe nga ligji i mëparshëm, ligji i ri përcakton edhe detyra dhe përgjegjësi specifike për institucione të tilla si: Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (ZMNV), Policia e Kosovës, Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale, Qendra për Punë Sociale, strehimoret, mediat dhe gjykatat.

Duke marrë parasysh që dhuna në familje në vendin tonë paraqitet më shpesh si dhunë ndaj grave (gruas, bijës, motrës, etj.), jo vetëm ky Ligj, por edhe instrumentet e tjera të lartpërmendura, përveç promovimit të barazisë së qytetarëve duke përfshirë komponentin gjinor, përqendrohen në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje ndaj grave duke përcaktuar mekanizma me qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e dinjitetit të tyre. Lidhur me zbatimin legjislativ, një shembull i dukshëm është vonesa gati dhjetëvjeçare në zbatimin praktik të Ligjit Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të Cilëve është Kufizuar me Vendim Gjyqësor, në fuqi që nga viti 2015. Megjithatë, për shkak të mungesës së buxhetimit dhe planifikimit të duhur, ky ligj filloi të zbatohet tek në fund të vitit 2024.⁸

Në këtë kontekst, mund të konkludohet se Kosova ka krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Megjithatë, përpjekjet institucionale duhet t'i japin më tej përparësi zbatimit efektiv dhe të qëndrueshëm të kësaj kornize, të forcojnë mbrojtjet ligjore, e veçanërisht ta adresojnë dhunën online kundër grave.

Ndryshimet në Kodin Penal parashikojnë një vepër penale të veçantë për ata që ushtrojnë qëllimisht dhunë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj grave që mbajnë funksione publike ose kandidateve për poste publike, me qëllim frikësimin ose detyrimin e tyre për të vepruar kundër vullnetit të tyre. Megjithatë, dhuna në internet duhet të njihet edhe si formë e përgjegjësisë penale në vend që të mbetet vetëm brenda mosmarrëveshjeve civile, siç janë fyerja ose shpifja.

Institucionet publike duhet të sigurojnë zbatimin e rreptë të kornizës ligjore për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Kjo qasje duhet të garantojë barazinë gjinore, të mbrojtë dinjitetin e çdo qytetari dhe të sigurojë që kryesit e krimit të marrin dënime dhe masa risocializimi të përshtatshme për të parandaluar përsëritjen e krimit në të ardhmen.

8 Telegrafi.com, Lansohet sistemi i hallkave për mbikëqyrje elektronike, si mjet për parandalimin e dhunës në familje, dhjetor 2024, i qasshëm në: <https://telegrafi.com/lansohet-sistemi-hallkave-per-mbeshitetje-elektronike-si-mjet-per-parandalimin-e-dhunes-ne-familje/>

4. Raportimi i Rasteve të Dhunës në Familje tek Policia e Kosovës

Policia e Kosovës luan një rol qendror në parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë sigurimin e mbrojtjes së viktimave, identifikimin e kryesve të krimit dhe mbështetjen e ndjekjes penale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përtej reagimit ndaj emergjencave, Policia e Kosovës është gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes të lëshuar nga gjykata dhe për ruajtjen e koordinimit efektiv me institucionet e tjera përkatëse të përfshira në adresimin e dhunës në familje.

Si bazë për vlerësimin e reagimit institucional ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, ky kapitull vlerëson performancën e Policisë së Kosovës për periudhën Janar – Dhjetor 2025. Analiza përqendrohet në shpërndarjen gjeografike të rasteve të raportuara, modelet gjinore, marrëdhëniet familjare midis viktimave dhe të dyshuarve, dhe grupmoshat më të prekura, duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të trendeve dhe dinamikave kryesore.

4.1 Shpërndarja rajonale e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës për dhunë në familje

Gjatë vitit 2025, Policia e Kosovës regjistroi gjithsej 2,815 raste të dhunës në familje, duke shënuar një rënie prej afërsisht 4.9% krahasuar me vitin 2024, kur u raportuan 2,961 raste.⁹ Sa i përket numrave absolutë, Prishtina përbën numrin më të lartë të rasteve të raportuara, me një total prej 960 rastesh. Ky rezultat është i pritshëm, duke pasur parasysh se Prishtina është kryeqyteti dhe rajoni më i populluar në vend. Ashtu si në vlerësimet e mëparshme vjetore të Just React, për të siguruar një vlerësim më të saktë dhe të krahasueshëm midis rajoneve, analiza zbatohet në shkallën e incidencës për 10,000 banorë, e cila merr parasysh ndryshimet në madhësinë e popullsisë. Kjo qasje e standardizuar mundëson një krahasim më të balancuar të incidencës së dhunës në familje ndërmjet rajoneve.¹⁰ Duhet theksuar se shifrat e popullsisë të përdorura në këtë analizë bazohen në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë, të kryer në vitin 2024.¹¹

Sipas të dhënave zyrtare të analizuara, **Mitrovica e Veriut**¹² regjistron incidencën më të lartë të rasteve të raportuara të dhunës në familje për periudhën e vëzhguar. Pavarësisht popullsisë relativisht të vogël prej 23,657 banorë, ky rajon tregon një shkallë incidence prej **24.93 raste për 10,000 banorë**, më i larti midis të gjitha rajoneve. Kjo tregon një nivel disproporcionalisht të lartë të rasteve të raportuara në krahasim me madhësinë e popullsisë. **Gjilani**¹³ vjen i dyti, me

9 Të dhënat u morën nga Policia e Kosovës përmes kërkesës për Lirinë e Informimit më 21 janar 2026.

10 Incidenca në kontekstin ligjor dhe penal është shkalla e rasteve të reja të një lloji specifik krimi, siç është dhuna në familje, që ndodhin brenda një popullsie gjatë një periudhe të caktuar.

11 Të dhëna nga regjistrimi i fundit i popullsisë, të aksesuara për herë të fundit në dhjetor 2025: https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Population_Estimate.%20projection%20and%20structure%20of%20population_Population%20estimate/tab03.px/

12 Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Veriut përfshin Mitrovicën e Veriut, Zubin Potokun, Zveçanin, Leposaviqin, shih më shumë në: <https://www.kosovopolice.com/en/regional-directorates/rdp-mitrovica-north/>.

13 Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan përfshin Gjilanin, Kamenicën dhe Vitinë, Novobërdën, Kllokotin, Parteshin dhe Ranillugën, shihni më shumë në: <https://www.kosovopolice.com/sq/regional-directorates/rdp-prishtina/>.

një incidencë prej **20.49 raste për 10,000 banorë**, të llogaritura nga një popullsi prej 154,669 banorë dhe 317 raste të raportuara.

Rajoni i **Pejës**¹⁴ renditet i treti, me një shkallë incidence prej **19.66 raste për 10,000 banorë**. **Peja** ka një popullsi prej 177,974 banorësh dhe regjistron 350 raste të raportuara gjatë periudhës së raportimit. **Prishtina**¹⁵ renditet pas Pejës, me një incidencë prej **18.94 raste për 10,000 banorë**. Si rajoni më i populluar, me 506,814 banorë dhe 960 raste të raportuara, Prishtina regjistron numrin më të lartë absolut të rasteve.

Më pas vijon **Gjakova**¹⁶ me një shkallë incidence prej **17.58 raste për 10,000 banorë**. Me një popullsi prej 164,386 banorësh dhe 289 raste të raportuara, incidenca e Gjakovës mbetet e moderuar krahasuar me rajonet e renditura më sipër. **Mitrovica Jugore**¹⁷ regjistron një incidencë prej **14.19 raste për 10,000 banorë**. Duke pasur parasysh një popullsi prej 166,934 banorësh dhe 237 raste të raportuara, ky rajon tregon një incidencë më të ulët krahasuar me rajonet me renditje më të lartë, pavarësisht një numri absolut të dukshëm rastesh. **Ferizaji**¹⁸ ka një shkallë incidence prej **13.73 raste për 10,000 banorë**, me 248 raste të raportuara prej një popullsie prej 180,583 banorë.

Prizreni¹⁹ regjistron incidencën më të ulët të rasteve të raportuara të dhunës në familje, me **12.79 raste për 10,000 banorë**. Pavarësisht se ka një popullsi të madhe prej 227,498 banorësh, Prizreni ka një numër të ulët rastesh të raportuara, vetëm 355.

Tabela 1. Rastet e dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës në periudhën janar - dhjetor 2025.

Rajoni	Numri i rasteve të raportuara	Popullsia e rajonit	Shkalla e 10,000 banorëve
Prishtinë	960	506,814	18.9
Gjilan	317	154,669	20.5
Ferizaj	248	180,583	13.7
Gjakovë	289	164,386	17.6
Pejë	350	177,974	19.7
Prizren	355	227,498	15.6
Mitrovicë e Jugut	237	166,934	14.2
Mitrovica e Veriut	59	23,657	24.9
Totali	2,815	1,602,505	17.6

14 Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë përfshin Pejën, Istogun, Klinën, Deçanin dhe Junikun, shihni më shumë në: <https://www.kosovopolic.com/sq/regional-directorates/rdp-peja/>.

15 Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë përfshin Prishtinën, Fushë Kosovën, Obiliqin, Podujevën, Lipjanin, Graçanicën dhe Drenasin, shihni më shumë në: <https://www.kosovopolic.com/sq/regional-directorates/rdp-prishtina/>.

16 Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë përfshin Gjakovën, Rahovecin dhe Malishevën, shihni më shumë në: <https://www.kosovopolic.com/sq/regional-directorates/rdp-gjakova/>.

17 Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën Jugore përfshin Mitrovicën Jugore, Vushtrrinë dhe Skenderajin, shihni më shumë në: <https://www.kosovopolic.com/en/regional-directorates/rdp-mitrovica-south/>.

18 Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj përfshin Ferizajn, Shtimen, Kaçanikun, Shtërpcën dhe Hanin e Elezit, shih më shumë në: <https://www.kosovopolic.com/sq/regional-directorates/rdp-ferizaj/>.

19 Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren përfshin Prizrenin, Suharekën, Mamushën dhe Dragashin, shihni më shumë në: <https://www.kosovopolic.com/en/regional-directorates/rdp-prizreni/>.


4.2 Dimensioi gjinor në rastet e dhunës në familje

Të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës për vitin 2025, pasqyrojnë qartë dimensionin gjinor të dhunës në familje, duke zbuluar një dallim të konsiderueshëm midis viktimave gra dhe burra në të gjitha rajonet. Shpërndarja e viktimave tregon vazhdimisht se gratë përbëjnë viktimat më të raportuara, ndërsa burrat përfaqësojnë një pjesë dukshëm më të vogël. Ky model nxjerr në pah jo vetëm përhapjen e dhunës në familje, por edhe vazhdimësinë e pabarazive gjinore dhe strukturat patriarkale brenda shoqërisë kosovare.

Kjo gjetje përputhet me standardet e njohura ndërkombëtarisht mbi dhunën me bazë gjinore. Në **Konventën e Stambollit**, dhuna ndaj grave njihet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit në bazë të gjinisë.²⁰ Një dhunë e tillë përfshin abuzimin fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik dhe në Kosovë pasqyron pozitën veçanërisht të cënueshme të grave brenda marrëdhënieve familjare dhe shoqërore.

Në nivel vendi, numri i përgjithshëm i viktimave është **2,836**, nga të cilat **2,137** ose **75.35%** e tyre janë gra dhe **699** ose **24.65%** janë burra. Një ndarje rajonale e përforcon më tej këtë çekuilibër gjinor. Në **Prishtinë**, **757 nga 960 (78.85%)** viktimat janë gra, ndërsa **203 janë burra (21.15%)**. Peja ka përqindjen më të lartë të viktimave gra, me 289 nga 349 (82.81%), e ndjekur nga afër nga **Mitrovica e Jugut**, ku **191 nga 237 (80.59%)** viktimat janë gra, dhe **Mitrovica e Veriut** ku **45 nga 56 (80.36%)** e totalit të viktimave të raportuara janë gra. Ferizaji tregon gjithashtu një përqindje të lartë të viktimave gra me 189 nga 240 (75.75%), ndërsa Gjakova raporton 220 viktimat gra nga 295 (74.85%). Gjilani dhe Prizreni shfaqin përqindje relativisht më të ulëta të viktimave gra, ku gratë ende mbeten shumicë në të dy rajonet, duke përbërë **206 nga 331 (62.24%)** në **Gjilan** dhe **240 nga 368 (65.22%)** në **Prizren**. Edhe në këto komuna, të dhënat konfirmojnë se dhuna në familje prek në mënyrë disproporcionale gratë, duke përforcuar përfundimin se dhuna në bazë gjinore mbetet e përhapur në tërë Kosovën, pavarësisht nga dallimet rajonale.


Grafiku 1. Shpërndarja gjinore e viktimave nëpër rajone të ndryshme gjatë periudhës janar - dhjetor 2025.




20 Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), e qasshme në: [CETS 210 - Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje](#)

Të dhënat janë në përputhje midis profileve të viktimës dhe kryesit të krimin. Nga **1,081 individë të arrestuar për dhunë në familje**, 992 ishin burra (91.7%), ndërsa 89 ishin gra (8.2%). Ndërsa, nga **2,998 të dyshuar gjithsej**, 2,519 ishin burra (84%) dhe 479 ishin gra (16%).

Grafiku 2. Shpërndarja gjinore e personave të dyshuar nëpër rajone të ndryshme gjatë periudhës janar - dhjetor 2025.



Grafiku 3. Shpërndarja gjinore e personave të arrestuar nëpër rajone të ndryshme gjatë periudhës janar - dhjetor 2025.




Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se dhuna në familje në Kosovë është kryesisht kundër grave. Ky realitet tregon ndikimin e vazhdueshëm të normave patriarkale dhe marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit, pavarësisht faktit se e drejta zakonore nuk përbën një burim formal të ligjit në Kosovë. Adresimi i këtij fenomeni kërkon jo vetëm zbatim efektiv të ligjit, por edhe ndryshime më të gjera shoqërore.

4.3 Roli i marrëdhënieve familjare në dinamikën e dhunës në familje

Të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës ofrojnë një pasqyrë të qartë se si ndodhë dhuna në familje brenda marrëdhënieve të ngushta familjare, shpesh duke përfshirë persona që janë të lidhur emocionalisht dhe ekonomikisht. Nga **2,827 persona** të përfshirë në dhunë në familje, të dhënat nga Policia e Kosovës tregojnë se **36.3% ose 1,026 janë bashkëshortët ata që ushtrojnë dhunë ndaj grave të tyre**, duke e bërë dhunën bashkëshortore formën më të zakonshme të dhunës në familje. Në mënyrë të ngjashme, **13.1% ose 370 burra** ushtruan dhunë ndaj partnerëve të tyre bashkëjetuese (grave) dhe **5.7% ose 160** e kryesve ishin ish-bashkëshortët ata që ushtruan dhunë ndaj ish-grave të tyre.


Grafiku 4. Marrëdhëniet midis të dyshuarve dhe viktimave: bashkëshortët dhe partnerët intimë.



Këto gjetje janë në përputhje me trendet globale. Sipas **Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rreth një në tri gra në mbarë botën (30%)** përjetojnë dhunë fizike ose seksuale nga një partner intim gjatë jetës së tyre²¹, duke vënë në pah se ky nuk është një problem i izoluar, por një problem shoqëror i përhapur gjerësisht.


Në marrëdhëniet e tjera familjare, të dhënat nga Policia e Kosovës tregojnë gjithashtu se dhuna në familje shtrihet përtej marrëdhënieve ndërmjet partnerëve. Një numër i konsiderueshëm rastesh përfshijnë dhunën prind-fëmijë, veçanërisht dhunën e kryer nga djemtë ndaj prindërve, si dhe incidente midis vëllezërve dhe motrave dhe anëtarëve të familjes së gjerë. **7% ose 197 djem** kanë kryer dhunë kundër babait të tyre, **5.6% ose 154 djem** kundër nënave të tyre. **4% ose 114 baballarë** kanë kryer dhunë kundër vajzave të tyre, ndërsa **3.5% ose 98 baballarë** kanë kryer dhunë kundër djemve të tyre.

Grafiku 5. Marrëdhëniet midis të dyshuarve dhe viktimave: marrëdhëniet prind-fëmijë.



21 Organizata Botërore e Shëndetësisë, Dhuna ndaj Grave, e qasshme në: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-women>.

Grafiku 6. Marrëdhëniet midis të dyshuarve dhe viktimave: vëllezër e motra.




Të gjithë të afërmit e tjerë, përfshirë vjehrrin, gjyshërit, njerken/njerkun, xhaxhallarët dhe hallat, si dhe nipërit dhe mbesat, përbëjnë **205 rastet e mbetura ose 7.25% të totalit** të rasteve të raportuara. Nga këto marrëdhënia midis vjehrrit (dhunuesit) dhe nuses bie më shumë në sy, me 30 raste, që përbëjnë 1.06%.

4.4 Analiza demografike e viktimave dhe të dyshuarve për dhunë në familje

Ky raport shqyrton gjithashtu **shpërndarjen e dhunës në familje sipas grupmoshës**, duke u përqendruar te viktimat me qëllim identifikimin e kategorive të moshës që preken më shumë. Të kuptuarit e profilit të moshës së viktimave ofron njohuri të rëndësishme mbi natyrën e dhunës në familje dhe ndihmon në informimin e zhvillimit të **politikave të synuara parandaluese dhe masave mbështetëse**.

Për vitin 2025, Policia e Kosovës regjistroi **2,836 viktimat të dhunës në familje**, me ndarjen e grupmoshave të paraqitur më poshtë.

Grafiku 7. Përmbledhje e grupmoshave për viktimat dhe të dyshuarit



Për periudhën raportuese, u regjistruan gjithsej **2,836 viktimat të dhunës në familje**. Të dhënat tregojnë një përqendrim të qartë të rasteve tek të rinjtë dhe të rriturit e moshës së mesme. Viktimat e moshës **20-30 vjeç** përfaqësojnë grupin më të madh, me **669 raste**, që përbëjnë afërsisht **23.6%** të të gjitha viktimave të regjistruara. Kjo pasohet nga afër nga grupmosha **30-40 vjeç**, me **630 viktimat** ose rreth **22.2%** të totalit.

Viktimat e moshës **40-50 vjeç** përbëjnë gjithashtu një pjesë të konsiderueshme, me **539 raste (19%)**, ndërsa ato të moshës **50-60 vjeç** përbëjnë **324 raste (11.4%)**. Së bashku, këto grupmosha konfirmojnë se dhuna në familje prek më shpesh individët aktivë në aspektin ekonomik e

social, një fazë jetësore që shpesh shoqërohet me përgjegjësi të shtuara familjare, presione financiare dhe stres ndërpersonal.

Në të njëjtën kohë, të dhënat nxjerrin në pah se dhuna në familje prek të gjitha grupmoshat, përfshirë fëmijët dhe të moshuarit. Një total prej **216 viktimash (7.6%)** janë nën moshën 18 vjeç, ndërsa **163 viktimash (5.7%)** bien brenda grupmoshës **18-20 vjeç**. Ndër të rriturit më të moshuar, **190 viktimash (6.7%)** janë të moshës **60-70 vjeç**, **81 viktimash (2.9%)** janë të moshës **70-80 vjeç** dhe 24 viktimash (0.8%) janë të moshës **80 vjeç e lart**.

Në total, u regjistruan **2,836 viktimash** të dhunës në familje, nga të cilat **92.4%** ishin të rritur, ndërsa **216 viktimash (7.6%)** ishin të mitur. Ndër të dyshuarit, **2,893 individë** ishin të rritur, që përfaqësojnë **96.5%** të të gjithë të dyshuarve, ndërsa **105 të dyshuar (3.5%)** ishin të mitur. Për më tepër, nga **1,081 individë të arrestuar** për dhunë në familje, **1,054 (97.5%)** ishin të rritur.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se individët e moshës **20-40 vjeç** përbëjnë pothuajse gjysmën e të gjitha viktimave të dhunës në familje, duke e bërë këtë segmentin e moshës më të prekur. Ky model thekson nevojën për **strategji parandaluese të ndjeshme ndaj moshës**, si dhe mbështetje psikosociale dhe institucionale të përshtatura që adreson sfidat specifike me të cilat përballen individët në këto grupmosha, duke siguruar njëkohësisht mbrojtje të përshtatshme si për viktimat më të reja ashtu edhe për ato më të moshuara.

5. Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje nga Prokurori i Shtetit

Prokurori i Shtetit (tutje referuar si: Prokuroria) luan një rol qendror në adresimin e dhunës në familje në Kosovë përmes hetimeve, ngritjes së aktakuzave dhe ndjekjes penale të kryesve të veprave penale. Ky kapitull vlerëson performancën e Prokurorisë Themelore gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, duke u përqendruar në të dhënat që lidhen me kallëzimet penale dhe aktakuzat për dhunë në familje. Analiza nxjerr në pah si aftësinë e Prokurorisë për të menaxhuar numrin e madh të lëndëve, ashtu edhe sfidat e vazhdueshme që lidhen me efikasitetin institucional, koherencën dhe qëndrueshmërinë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Si pjesë e këtij vlerësimi, ky kapitull shqyrton gjithashtu treguesit rajonalë mbi shpërndarjen e aktakuzave, duke ofruar një pasqyrë më të qartë të efektivitetit të prokurorisë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Siç është vënë në pah në vlerësimet e mëparshme të Just React, Prokurorisë vazhdon t'i mungojnë të dhëna të ndara mbi gjininë e të dyshuarve dhe viktimave. Ky boshllëk tregon nevojën për një bashkëpunim më të fortë ndërinstitucional dhe krijimin e një sistemi të përbashkët të të dhënave që do të lejonte tregues të unifikuar dhe një analizë më gjithëpërfshirëse të rasteve të dhunës në familje. Sistemi për Menaxhimin e Informacionit të Rasteve që përdoret nga gjykatat duhet të përdoret në mënyrë më efektive dhe të integrohet plotësisht me bazën e të dhënave shtetërore në mënyrë që të përmirësohet saktësia, qëndrueshmëria dhe qasshmëria e të dhënave në të gjitha institucionet. Një integrim i tillë do të mundësonte ndarjen e informacionit në kohë reale ndërmjet gjykatave, prokurorisë, policisë dhe shërbimeve sociale, do të zvogëlonte fragmentimin e të dhënave dhe do të mbështeste zhvillimin e treguesve të unifikuar për monitorimin e rasteve të dhunës në familje. Si përfundim, një sistem i ndërlidhur do ta forconte koordinimin institucional, do ta përmirësonte ndjekjen e rasteve në tërë zinxhirin e drejtësisë dhe do të kontribonte në hartimin e politikave më të informuara dhe në ndërhyrjet e bazuara në prova.

5.1 Kallëzimet dhe Aktakuzat Penale: Iniciativa për Drejtësi dhe Mbrojtje

Në sistemin e drejtësisë penale, kallëzimet penale janë pika kryesore hyrëse për identifikimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, pasi ato shkaktojnë veprime hetimore dhe prokuroriale. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre veprave penale, kallëzimet penale luajnë një rol kyç në zbulimin e fushëveprimit të problemit, si për institucionet ashtu edhe për publikun e gjerë. Ato janë gjithashtu hapi i parë formal në procesin e drejtësisë penale, duke lejuar fillimin e procedurave kundër autorëve dhe duke u lejuar viktimave të kenë qasje në masa mbrojtëse, duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes, shërbimet sociale dhe mbështetjen ligjore.

Sipas të dhënave zyrtare, në vitin 2025, Prokuroria pranoi gjithsej **2,453** kallëzime penale që lidhen me dhunën në familje në tërë Kosovën²², nga të cilat **1,901** çuan në aktakuza. Kjo korrespondon me një shkallë aktakuzash prej **77.5%**, duke treguar se më shumë se gjysma e rasteve të raportuara kanë kaluar në fazën e aktakuzës. Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritur më së shumti kallëzime penale, **207 akuza** nga 244 raporte me një shkallë aktakuzash prej **84.8%**. Prokuroria e **Prizrenit** mban shkallën e dytë më të lartë të aktakuzave për kallëzim penal prej **78.5%**. **Peja** vjen pas saj me një shkallë aktakuzash prej **76.6%**. Ndërsa **Prishtina** ka numrin më të lartë të raportimeve dhe aktakuzave, përkatësisht **1,020** dhe **718**, me një shkallë aktakuzash prej 70.4%.

Tabela 2. Rastet e dhunës në familje të raportuara në Prokuroritë Themelore në periudhën janar - dhjetor 2025.

Prokuroria Themelore	Kallëzime penale të pranuar	Numri i aktakuzave	Shkalla e aktakuzave %
Prishtinë	1,020	718	70.4
Gjilan	232	207	89.2
Ferizaj	212	117	55.2
Gjakovë	276	204	73.9
Pejë	359	275	76.6
Prizren	354	278	78.5
Mitrovicë	190	102	53.7
Totali	2,453	1,901	77.5

Ndërkohë që kjo shifër në tërë vendin tregon një nivel të konsiderueshëm të angazhimit të prokurorisë, ajo gjithashtu sugjeron që një pjesë e konsiderueshme e kallëzimeve penale nuk kanë rezultuar në aktakuza. Kjo mund të nënkuptojë që raportet e hartuara nga policia nuk kanë një bazë të fortë që prokuroria të vazhdojë më tej me ngritjen e aktakuzave.

22 Të dhënat e marra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes kërkesës për Lirinë e Informimit, më 9 dhe 14 janar 2026. Për numrin e aktakuzave në Pejë, të dhënat u morën më 29 janar 2026 nga Prokuroria Themelore në Pejë.

5.2 Ndarja rajonale e aktakuzave për dhunë në familje

Kjo pjesë trajton analizën e shpërndarjes rajonale të aktakuzave për vepra penale të dhunës në familje në tërë Kosovën. Për të siguruar një vlerësim të standardizuar dhe të krahasueshëm, zbatohet e njëjta metodologji e përdorur për shpërndarjen rajonale të raportimeve të dhunës në familje të regjistruara nga Policia e Kosovës. Shkalla e aktakuzave për 10,000 banorë llogaritet për secilin rajon, bazuar në madhësinë përkatëse të popullsisë.

Bazuar në të dhënat e ofruara nga Këshilli Prokurorial për vitin 2025, **Peja**²³ ka numrin më të madh të rasteve të raportuara për 10,000 banorë, **20.2 kallëzime penale** dhe një shkallë aktakuzash prej **15.5 aktakuzash** për 10,000 banorë. Rajoni i Prishtinës²⁴ ka një incidencë po aq të lartë të aktakuzave, me **14.2 aktakuza** dhe **20.1 kallëzime penale** për 10,000 banorë. **Gjilani**²⁵ ka një incidencë prej 13.4 aktakuzash dhe 15 kallëzimesh penale për 10,000 banorë, duke reflektuar një reagim po aq aktiv të prokurorisë ndaj rasteve të dhunës në familje. **Gjakova**²⁶ dhe **Prizreni**²⁷ tregojnë nivele të krahasueshme të aktakuzave, secila me një incidencë prej **12.4 dhe 12.2 aktakuzash**, përkatësisht, dhe 16.8 dhe 15.6 kallëzimesh penale. Në anën tjetër, **Ferizaj**²⁸ regjistron një incidencë dukshëm më të ulët të aktakuzave, me **6.5** dhe një incidencë më të lartë të kallëzimeve penale prej 11.7, ndërsa Mitrovica²⁹ ka një incidencë prej 5.4 aktakuzave dhe 10 kallëzimeve penale. Mesatarja kombëtare e incidencës së padive për 10,000 banorë është **11.9** dhe mesatarja e kallëzimeve penale për 10,000 është **15.3**. Duhet theksuar se, për qëllimet e kësaj analize, Mitrovica vlerësohet si një rajon i vetëm, pa dallim midis Veriut dhe Jugut, bazuar në juridiksionin territorial të Zyrës së Prokurorit, me një popullsi totale prej 190,591 banorësh.

Tabela 3. Ndarja rajonale e kallëzimeve penale për dhunën në familje gjatë vitit 2025

Prokuroria Themelore	Kallëzime penale të pranuar	Popullsia e rajonit	Incidenca e Kallëzimeve Penale për 10,000 banorë
Prishtinë	1,020	506,814	20.1
Gjilan	232	154,669	15.0
Ferizaj	212	180,583	11.7
Gjakovë	276	164,386	16.8
Pejë	359	177,974	20.2
Prizren	354	227,498	15.6
Mitrovicë	190	190,591	10.0
Totali	2,453	1,602,515	15.3

23 Prokuroria Themelore e Pejës mbulon Pejë, Deçanin, Klinën, Istogun dhe Junikun, shih më shumë në: <https://pthpeje.prokuroria-rks.org/>.

24 Prokuroria Themelore e Prishtinës mbulon Prishtinën, Fushë Kosovën, Drenasin, Graçanicën, Lipjanin, Obiliqin dhe Podujevën, shih më shumë në: <https://pthprishtine.prokuroria-rks.org/>.

25 Prokuroria Themelore e Gjilanit mbulon Gjilanin, Kamenicën, Ranillukun, Novobërdën, Vitinë, Kllokotin dhe Parteshin, shih më shumë në: <https://pthgjilan.prokuroria-rks.org/>.

26 Prokuroria Themelore e Gjakovës mbulon Gjakovën, Malishevën dhe Rahovecin, shih më shumë në: <https://pthgjakove.prokuroria-rks.org/>.

27 Prokuroria Themelore e Prizrenit mbulon Prizrenin, Suharekën, Dragashin dhe Mamushën, shih më shumë në: <https://pthprizren.prokuroria-rks.org/>.

28 Prokuroria Themelore e Ferizajt mbulon Ferizajn, Kaçanikun, Shtimen, Shtërpçën dhe Hanin Elezit, shih më shumë në: <https://pthferizaj.prokuroria-rks.org/>.

29 Prokuroria Themelore e Mitrovicës mbulon Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Leposaviqin, Zubin Potokun, Zveqanin, Skenderajn dhe Vushtrinë, shihni më shumë në: <https://pthmitrovice.prokuroria-rks.org/>.


Tabela 4. Ndarja rajonale e aktakuzave për dhunë në familje gjatë vitit 2025

Rajoni	Numri i aktakuzave	Popullsia e rajonit	Incidenca e aktakuzave për 10,000 banorë
Prishtinë	718	506,814	14.2
Gjilan	207	154,669	13.4
Ferizaj	117	180,583	6.5
Gjakovë	204	164,386	12.4
Pejë	275	177,974	15.5
Prizren	278	227,498	12.2
Mitrovicë	102	190,591	5.4
Totali	1,901	1,602,515	11.9

5.3 Vlerësimi i performancës së Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje: efikasiteti dhe sfidat

Një pjesë integrale e këtij kapitulli është vlerësimi i performancës së Prokurorisë për vitin 2025, bazuar në të dhënat e ofruara nga KPK-ja dhe të analizuar në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).³⁰ CEPEJ zbaton tregues kyç të performancës, siç janë Shkallës së Zgjidhjes së Lëndëve (%), Raporti i Qarkullimit të Lëndëve dhe Koha e Zgjidhjes së tyre për të vlerësuar efikasitetin e institucioneve të drejtësisë.

Bazuar në të dhënat e konsoliduara nga zyrat e prokurorive themelore, gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, u pranuan gjithsej 2,453 raste të reja të dhunës në familje, ndërsa u zgjidhën 2,220 raste. Në fund të periudhës raportuese, mbetën të pazgjidhura 233 raste.

Grafiku 8. Raporti midis lëndëve të zgjidhura dhe atyre në pritje në prokurori në vitin 2025

› Përqindja e Shkallës së Zgjidhjes 2025

Shkalla e Trajtimit të Lëndëve (Shkalla e Zgjidhjes %)³¹ mat raportin midis lëndëve të zgjidhura dhe rasteve të pranuar rishtazi gjatë periudhës raportuese dhe pasqyron aftësinë e Prokurorisë për të menaxhuar numrin e lëndëve të pranuar. Për periudhën në shqyrtim, prokuroria ka pranuar gjithsej 2,453 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 2,220 prej tyre. Shkalla e Zgjidhjes është 90.5%, duke treguar se Prokuroria zgjidhi shumicën e lëndëve të pranuar gjatë vitit.

30 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Udhëzimet e CEPEJ mbi Statistikat Gjyqësore, të qasshme në: <https://rm.coe.int/1680747678>.

31 Në vend të shprehjes zgjidhje (resolving), do të përdoret termi trajtim (handling), sepse zyrat e prokurorive nuk japin vendimet përfundimtare.

› Raporti i Qarkullimit të Lëndëve në vitin 2025

Raporti i Qarkullimit të Lëndëve (RQL) llogaritet si raporti midis lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pazgjidhura dhe ilustron aftësinë e institucionit për t'u përballur me ngarkesën e përgjithshme të lëndëve, duke përfshirë edhe lëndët e prapambetura nga periudhat e mëparshme. Nga numri i lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve të pazgjidhura, **RQL për vitin 2025 është 9.5 (2,220/233)**, që do të thotë se Prokuroria zgjidhi rreth nëntë herë numrin e lëndëve që mbetën në pritje. Kjo përfaqëson një kapacitet relativisht të fortë qarkullimi të lëndëve dhe tregon përpjekje të vazhdueshme për të zvogëluar ngarkesën e lëndëve të prapambetura.

› Koha e Zgjidhjes për vitin 2025

Koha e Zgjidhjes (KZ) vlerëson kohën mesatare të nevojshme për të zgjidhur një lëndë dhe llogaritet duke lidhur 365 ditët e periudhës raportuese me Raportin e Qarkullimit të Lëndëve. Për vitin 2025, Koha e Zgjidhjes së Lëndëve për prokuroritë themelore vlerësohet të jetë afërsisht **38.4 ditë (365/9.5)**.

Si përfundim, treguesit e performancës tregojnë se Prokuroria ka demonstruar një nivel të fortë efikasiteti në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, veçanërisht në aspektin e qarkullimit të rasteve dhe shpejtësisë së përpunimit. Megjithatë, vëllimi i lartë i rasteve dhe numri i dosjeve të pazgjidhura mbeten shqetësuese. Kjo na vë në pah se, përtej efikasitetit institucional, ekziston një boshllëk i vazhdueshëm në parandalimin dhe adresimin strukturor të dhunës në familje, prandaj nevojiten politika më të forta parandaluese, ndërhyrje të hershme dhe veprime të koordinuara midis institucioneve.

Grafiku 9. Krahasimi i të dhënave për Shkallën e Zgjidhjes %, Shkallën e Qarkullimit të Lëndëve dhe Kohën e Zgjidhjes gjatë vitit 2025 me periudhën Korrik 2023 - Qershor 2024

	Shkalla e Zgjidhjes %	Raporti i Qarkullimit të Lëndëve	Koha e Zgjidhjes
2025	90.5%	9.5	38.4 days
Korrik 2023 – Qershor 2024	102.6%	2.7	131 days

6. Trajtimi I Rasteve të Dhunës në Familje në Procedurën Penale nga Gjykatat Themelore në Kosovë Gjatë Vitit 2025

Ky kapitull analizon efikasitetin e shtatë gjykatave themelore dhe degëve të tyre përkatëse në lidhje me zhvillimin e procedurave penale në rastet e dhunës në familje.³² Vlen të përmendet se më 16 janar 2026, Koordinator i Rasteve të Dhunës në Familje raportoi në KGJK. Sipas këtij raporti, gjykatat në nivel kombëtar për vitin 2025 kanë pranuar 1,013 raste dhe kanë zgjidhur 1,032 raste, pra një efikasitet prej 101%, pra duke përfshirë rastet që kanë qenë aktive në gjykata para vitit 2025.³³ Ndërkohë, raporti i GLPS-së analizon të dhënat e ofruara nga Zyra e Statistikave të KGJK-së, duke llogaritur efikasitetin vetëm në rastet e pranuar në vitin 2025, sipas metodologjisë së CEPEJ-it.

Pjesa e parë e këtij kapitulli përfshinë të dhëna të marra nga baza e të dhënave e KGJK-së, duke përfshirë elemente të rëndësishme si: numri i rasteve të pranuar, të zgjidhura, lloji i vendimit gjyqësor, lloji i sanksionit penal të shqiptuar dhe kohëzgjatja mesatare e procedurës penale nga pranimi i rastit deri në ditën e shpalljes së vendimit. Ndërsa pjesa e dytë do të analizojë të dhënat e marra përmes monitorimit sistematik të gjykatave përmes Just React.

Të dhënat e marra nga KGJK-ja analizohen në terma sasiorë dhe cilësorë duke përdorur tregues të përcaktuar në metodologjinë e CEPEJ-it, siç janë: Shkalla e Zgjidhjes (%), Raporti i Qarkullimit të Lëndëve dhe Koha e Zgjidhjes. Për më tepër, KGJK-ja ka miratuar Planin Strategjik të Teknologjisë së Informacionit 2024-2029 për zbatimin e mjeteve të drejtësisë digjitale të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).³⁴

Bazuar në të dhënat e KGJK-së për vitin 2025, gjykatat e shkallës së parë së bashku me degët e tyre kanë pranuar gjithsej **1007 raste** me veprën penale “Dhunë në familje” të përcaktuar në nenin 248 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Nga këto raste të pranuar, **568** janë zgjidhur, ndërsa numri i përgjithshëm i rasteve të pazgjidhura për periudhën raportuese arrin në **439 raste**.

Grafiku 10. Raporti midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre në pritje në gjykata në vitin 2025



32 Baza e të dhënave e rasteve penale të dhunës në familje, e marrë nëpërmjet Departamentit të Statistikave në KGJK, shkurt 2026.

33 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Periodik mbi Rastet e Dhunës në Familje, Janar 2026, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/69086_KGJK_RAPORT_PERIODIK_PER_RASTET_DHUNES_NE_FAMILJE_2025.pdf

34 Plani strategjik i IT-së i Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2024-2029: Zbatimi i Mjeteve të Drejtësisë Digjitale të CEPEJ-it, në dispozicion në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/77949_KGJK_Plani_Strategjik_TI_se_%202024_2029_Zbatimi_Mjeteve_te_drejtësisë_digjitale_te_CEPEJ.pdf.

› Përqindja e Shkallës së Zgjidhjes për vitin 2025

Shkalla e Zgjidhjes së lëndëve përkufizohet si raporti i rasteve të zgjidhura me rastet e reja të pranuar, shumëzuar me 100, për të marrë përqindjen e kapacitetit punues të gjykatave themelore në Kosovë për periudhën raportuese. Në këtë periudhë raportuese, Shkalla e Zgjidhjes (në tekstin e mëtejshëm: ShZ) në Kosovë është 56%, një rezultat që pasqyron se gjykatat po përballen me sfida në menaxhimin efektiv të rasteve. Kjo përqindje e efikasitetit të gjykatave themelore për këtë periudhë raportuese pasqyron një sfidë në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje nga gjyqësori, duke mos arritur të zgjidhë as gjysmën e rasteve që kanë pranuar në periudhën janar - dhjetor 2025.


Tabela 5. Të dhëna mbi numrin e lëndëve të pranuar, lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pazgjidhura në Gjykatat Themelore dhe degët e tyre për vitin 2025

	Rastet e pranuar	Rastet e zgjidhura	Raste të pazgjidhura
GjTh Prishtina	192	108	84
Dega Podujevë	61	41	20
Dega Graçanicë	18	10	8
Dega Lipjan	34	13	21
Dega Glllogovc	34	22	12
Dega Fushë Kosovë	90	51	39
GjTh Gjilan	74	26	48
Dega Kamenicë	15	10	5
Dega Vitia	19	12	7
Dega Novobërdë	5	1	4
GjTh Prizren	88	55	33
Dega Suharekë	21	8	13
Dega Dragash	2	1	1
GjTh Mitrovica	16	10	6
Dega Leposaviq	0	0	0
Dega Vushtrri	12	5	7
Dega Zubin Potok	0	0	0
Dega Skënderaj	7	6	1
GjTh Gjakova	63	47	16
Dega Malishevë	23	7	16
Dega Rahovec	32	24	8
GjTh Peja	93	50	43
Dega Istog	25	13	12
Dega Klinë	21	14	7
Dega Deçan	10	4	6
GjTh Ferizaj	43	23	20
Dega Kaçanik	3	2	1
Dega Shtërpçë	6	5	1
Totali	1007	568	439

› Raporti i Qarkullimit të Lëndëve në vitin 2025

Raporti i Qarkullimit të Lëndëve (RQL) përfaqëson raportin midis lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë një periudhe të caktuar dhe si tregues mat aftësinë e sistemit për t'u përballur dhe për të zgjidhur ngarkesën totale të lëndëve, duke përfshirë ato të pazgjidhura nga periudhat e mëparshme. Duke pasur parasysh se gjykatat themelore gjatë periudhës raportuese kanë zgjidhur 568 lëndë, ndërsa 439 mbeten të pazgjidhura, RQL është 1.3, që përfaqëson një raport më të lartë midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre që mbeten në punë. Prandaj, kjo vlerë e RQL tregon se gjykatat janë në gjendje ta përballojnë fluksin e lëndëve dhe të mbajnë numrin e lëndëve të zgjidhura më të lartë se numrin e lëndëve që presin epilogun.

Grafiku 11. Treguesi i Raportit të Qarkullimit të Lëndëve për gjykatat



CTR 568/439=1.3

› Koha e Zgjidhjes

Koha e Zgjidhjes përfaqëson raportin midis periudhës së raportimit - 365 ditë të vitit dhe shkallës së qarkullimit të lëndëve të realizuara nga gjykatat. Treguesi synon të pasqyrojë kohën, përkatësisht numrin mesatar të ditëve të nevojshme për ta përfunduar një lëndë nga pranimi i saj deri në dhënien e vendimit. Nga raporti i ditëve të periudhës së raportimit dhe vlerës së RQL-së, rezulton se gjykatave themelore iu deshën rreth 281 ditë për të zgjidhur një lëndë brenda periudhës së raportimit (365/1.3). Kjo vlerë e Kohës së Zgjidhjes tregon se gjykatat e shkallës së parë nuk janë treguar efikase për sa i përket kohës për trajtimin e lëndëve, as në krahasim me standardet evropiane dhe as me vetë efikasitetin e treguar, p.sh. në periudhën korrik 2023 - gusht 2024. Ky rezultat pasqyron nevojën për menaxhim më adekuat nga ana e gjykatave kur trajtohen rastet e dhunës në familje.

Grafiku 12. Treguesi i kohës së zgjidhjes

Periudha e raportimit	365
RQL	1.3
Koha e Zgjidhjes	Periudha e raportimit/RQL = 281

Grafiku 13. Krahasimi i të dhënave për Shkallën e Zgjidhjes %, Shkallën e Qarkullimit të Lëndëve dhe Kohën e Zgjidhjes gjatë vitit 2025 me periudhën Korrik 2023 - Qershor 2024

	Shkalla e Zgjidhjes %	Raporti i Qarkullimit të Lëndëve	Koha e Zgjidhjes
2025	56%	1.3	281 ditë
Korrik 2023 – Qershor 2024	74%	1.3	262 ditë


6.1 Analiza e të dhënave mbi vendimet penale përfundimtare në rastet e dhunës në familje nga Gjykatat Themelore në Kosovë

Kjo pjesë do t'i analizojë tri elemente të rëndësishme të vendimmarrjes së gjykatave themelore në rastet e dhunës në familje. Fillimisht, do të analizohet se çfarë lloje vendimesh kanë dhënë gjykatat në lidhje me të pandehurit për këtë veprë penale, pastaj cilat kanë qenë dënimet më të shpeshta të shqiptuara, në sa nga rastet e trajtuara ka pasur pranim fajësie nga të pandehurit dhe sa shpesh gjykatat kanë dhënë vendime në rastet e dhunës në familje gjatë periudhës raportuese.


Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (KPP), gjykatat mund të shpallin tri lloje vendimesh pas shqyrtimit të aktakuzës kundër të pandehurve për dhunë në familje dhe vepra të tjera penale. Kështu, gjykatat mund të shpallin një aktgjykim dënues nëse i pandehuri pranon fajësinë ose gjatë procedurës vërtetohet se ai ose ajo ka kryer veprën penale. Në rastet kur vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën veprë penale, ose ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale ose nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata lëshon një aktgjykim lirues. Lloji i tretë i vendimit është aktgjykim i refuzues, i cili lëshohet në rastet kur: prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të seancës gjyqësore; i pandehuri është gjykuar për të njëjtën veprë penale me një vendim të formës së prerë; afati i parashkrimit ka skaduar dhe vepra penale është përfshirë në një amnisti ose falje, ose kur ka rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale; ose kur i dëmtuari tërhiqet nga propozimi për një veprë penale që nuk ndiqet sipas detyrës zyrtare, përveç nëse gjykata ka prova se vendimi për tërheqje është ndikuar padrejtësisht nga një palë e tretë.

Të dhënat e ofruara nga KGJK-ja për vitin 2025 pasqyrojnë një shkallë të lartë dënimesh, që nënkupton se mbi **87%** e të akuzuarve për dhunë në familje janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar nga gjykatat, dhe kjo shkallë përkon edhe me nivelin profesional të aktakuzave të ngritura nga Prokurori i Shtetit, pasi ato po arrijnë kryesisht të përcaktojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve, qoftë duke pranuar fajësinë ose gjatë procesit gjyqësor.


Grafiku 14. Llojet e vendimeve gjyqësore për rastet e dhunës në familje



Nga 495 raste ku gjykatat kanë dhënë vendime fajësie, vetëm në 145 raste janë shqiptuar dënime efektive si burgim, burgim dhe gjobë, si dhe vetëm gjobë. Pjesa tjetër e dënimeve janë dënime me kusht, vërejtje gjyqësore dhe masa për trajtim të detyrueshëm. Më saktësisht, vetëm për 1 nga 3 raste të dhunës në familje gjykatat shqiptojnë dënime efektive, ndërsa në rreth 70% të rasteve shqiptohen dënime me kusht, vërejtje gjyqësore ose masa të tjera. KPRK-ja përcakton shprehimisht se dënimi për personat e shpallur fajtorë për veprën penale të dhunës në familje është gjobë dhe burgim deri në 3 vjet. Prandaj, kjo dispozitë është e qartë në lidhje me masën ndëshkuese që gjykatat duhet të shqiptojnë, por të dhënat tregojnë se vetëm në 14% të rasteve shqiptohet dënimi kumulativ i përcaktuar në KPRK.

Grafiku 15. Llojet e dënimeve në rastet e dhunës në familje

Të dhënat e ofruara nga KGJK-ja mbi vendimet gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë në procedurat penale të zhvilluara kundër të pandehurve për dhunë në familje rezultojnë se në 85% të rasteve ato janë zgjidhur me pranim fajësie. Pra, në 487 nga 568 raste të zgjidhura, të pandehurit kanë pranuar fajësinë e tyre lidhur me akuzën për veprën penale të dhunës në familje. Kjo rrethanë ka ndikuar që gjykatat në të gjitha këto raste të shpallin aktgjykime dënuese, por ajo që mbetet shqetësuese është politika ndëshkuese që gjykatat po ndjekin në lidhje me këta të pandehur.

Grafiku 16. Raporti midis rasteve të zgjidhura dhe numrit të rasteve me pranim fajësie

Duke pasur parasysh se ekziston një shkallë kaq e lartë e rasteve ku të pandehurit për dhunë në familje pranojnë fajësinë, kjo duhet të pasqyrojë efikasitetin kohor të gjykatave në zgjidhjen e rasteve. Siç u përmend më sipër, nëse kohëzgjatja mesatare e zgjidhjes së rasteve është 281 ditë, kjo duhet të nënkuptojë që gjykatat duhet të jenë më proaktive në trajtimin e këtyre rasteve, duke minimizuar arsyet e vonësës së tyre, qoftë për shkak të mungesës së palëve apo pengesave të tjera procedurale.

Pjesa në vijim analizon se cila gjykatë themelore demonstroi efikasitetin më të lartë në dhënien e vendimeve përfundimtare për rastet e dhunës në familje gjatë vitit 2025. Kjo bëhet duke pjesëtuar numrin e rasteve të zgjidhura me numrin e ditëve në periudhë, duke dhënë një masë se sa ditë, mesatarisht, u deshën për të zgjidhur të paktën një rast të dhunës në familje.

Tabela 6. Kohëzgjatja mesatare e zgjidhjes së lëndëve në degët e gjykatave

	Rastet e zgjidhura	Ditët e periudhës së raportimit	Kohëzgjatja mesatare në ditë
GjTh Prishtina	83	365	4
Dega Podujevë	41	365	9
Dega Graçanicë	10	365	37
Dega Lipjan	13	365	28
Dega Glllogoc	22	365	17
Dega Fushë Kosovë	51	365	7
GjTh Gjiilan	26	365	14
Dega Kamenicë	10	365	37
Dega Viti	7	365	52
Dega Novobërdë	1	365	365
GjTh Prizren	55	365	7
Dega Suharekë	8	365	46
Dega Dragash	1	365	365
GjTh Mitrovica	10	365	37
Dega Leposaviq	0	365	0
Dega Vushtrri	5	365	73
Dega Zubin Potok	0	365	0
Dega Skënderaj	6	365	61
GjTh Gjakova	47	365	8
Dega Malishevë	7	365	52
Dega Rahovec	24	365	15
GjTh Peja	50	365	7
Dega Istog	13	365	28
Dega Klinë	14	365	26
Dega Deçan	4	365	91
GjTh Ferizaj	23	365	16
Dega Kaçanik	2	365	183
Dega Shtërpçë	5	365	73

Siç pasqyrohet në tabelën e mësipërme, Gjykata Themelore në Prishtinë kryeson për sa i përket efikasitetit mesatar kohor të zgjidhjes së rasteve, kështu që të paktën çdo të katërtën ditë të periudhës raportuese ka nxjerrë një vendim në rastet e dhunës në familje. Pas saj, sipas kësaj mesatareje, vijnë Gjykata Themelore në Pejë dhe në Prizren, ndërsa Gjykatat e Degëve të Novobërdës dhe Dragashit kanë nxjerrë vendime në rastet e dhunës në familje më rrallë, përkatësisht një herë për tërë periudhën e vitit.

Duke qenë se me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2025 për publikimin e vendimeve gjyqësore, KGJK-ja ka ndaluar publikimin e vendimeve në lidhje me veprat penale të kryera brenda një marrëdhënieje familjare, përfshirë ato të dhunës në familje, përveç transparencës gjyqësore, kjo e ka bërë edhe më të vështirë analizimin e mënyrës se si po trajtohen këto raste nga gjykatat. Prandaj, mbetet detyrim i KGJK-së, brenda këtyre rrethanave, të zbatojë një zgjidhje që, nga njëra anë, mbron konfidencialitetin e procedurave penale në rastet e dhunës në familje, ndërsa nga ana tjetër, ofron të dhëna mbi tregues të ndryshëm në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve nga gjykatat themelore, konkretisht për qëllime kërkimore.

6.2 Brenda Gjykatave: Analiza nga Monitorimi i Gjykatave

Ky kapitull do t'i analizojë të dhënat e marra përmes monitorimit të drejtpërdrejtë gjyqësor të rasteve të dhunës në familje në seancat gjyqësore të mbajtura në shtatë gjykatat themelore të Kosovës. Kapitulli mbulon periudhën maj-dhjetor 2025 dhe është i ndarë në dy kategori: raste të dhunës në familje dhe raste të tjera të dhunës me bazë gjinore, ku elementi kryesor është fakti që të akuzuarit dhe viktimat janë të gjinive të ndryshme.³⁵ Gjatë kësaj periudhe, u monitoruan gjithsej 830 seanca gjyqësore, nga të cilat 448 ishin me natyrë dhune në familje, ndërsa 382 seanca të tjera ishin me elemente të dhunës me bazë gjinore ose veprave të tjera penale që lidhen me këtë element.

Tabela 7. Seancat e monitorimit të gjykatave maj-dhjetor 2025

Monitorimi i Gjykatave (Maj-Dhjetor 2025)	Rastet gjyqësore të dhunës në familje	Seancat gjyqësore për dhunën në familje	Rastet gjyqësore të dhunës me bazë gjinore	Seanca gjyqësore për dhunën me bazë gjinore
GjTh Prishtinë	54	55	27	42
GjTh Gjilan	73	89	69	73
GjTh Prizren	80	96	31	62
GjTh Mitrovica	24	28	39	44
GjTh Gjakova	81	114	48	62
GjTh Peja	1	1	1	1
GjTh Ferizaj	89	64	30	98
Totali	402	448	245	382

Lidhur me fazën e procedurës penale, u monitoruan 447 seanca fillestare dhe 327 seanca të shqyrtimit gjyqësor kundër të pandehurve. Përveç kësaj, u monitoruan 56 seanca të tjera që kanë të bëjnë me procedurën për caktimin e urdhrave mbrojtës nga departamenti civil i gjykatave përkatëse ose shpalljen e vendimeve. Sipas të dhënave të monitorimit, rreth 54% e seancave gjyqësore të monitoruara ishin në rastet ku u mbajt shqyrtimi fillestar i aktakuzave. Rreth 40% e seancave të tjera kishin të bënin me monitorimin e rasteve në fazën e seancës gjyqësore, ndërsa 6% e numrit të përgjithshëm të seancave të monitoruara ishin të natyrës së caktimit të urdhrave mbrojtës, shpalljes së vendimeve, etj.

³⁵ Baza e të dhënave e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, e ofruar nga monitorimi në kuadër të Just React.

Grafiku 17. Natyra e procedurave të lëndëve gjyqësore të monitoruara



Çështjet gjyqësore të monitoruara gjatë kësaj periudhe u karakterizuan edhe nga anulimi i seancave gjyqësore. Kështu, nga 830 seanca të monitoruara, 260 prej tyre u shtynë për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore. Arsyeja kryesore për shtyrjen e seancave gjyqësore ishte mungesa e palëve. Kështu, në 155 nga 260 seancat e shtyra, arsyeja ishte mospresencimi i pranisë së të pandehurit në procedurën penale, 22 seanca gjyqësore nuk u mbajtën për shkak të mungesës së prokurorit, ndërsa të tjerat u shtynë për shkak të mungesës së avokatëve, mbrojtja nuk ishte pajisur me shkresat e lëndës nga Prokuroria, etj.

Grafiku 18. Raporti midis seancave gjyqësore të mbajtura dhe të shtyra




Tabela 8. Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore

Mossigurimi i pranisë së të pandehurit	Numri
Mungesa e prokurorit të shtetit	22
Me kërkesë të prokurorit të shtetit	10
Mungesa e viktimës	6
Mungesa e dëshmitarit	5
Të tjera	62

Ekipi i monitorimit vëzhgoi gjithashtu seanca gjyqësore të karakterizuara nga shkelje procedurale dhe menaxhim joadekuat nga gjyqtarët. Disa nga çështjet kryesore procedurale dhe mangësitë e tjera të identifikuara përfshijnë:

Shkelje procedurale dhe mungesë e menaxhimit të duhur	
1	Regjistrimi i gabuar i rrjedhës së procedurës në procesverbal
2	Moskontaktimi i një avokati ex officio për të pandehurin pavarësisht kërkesës nga pala
3	Mosdhënia e shkresave të lëndës për palët nga Prokurori i Shtetit dhe rastet e mbajtjes së seancave gjyqësore pa përmbushur këtë detyrim ligjor
4	Nivel i pakënaqshëm trajtimi i viktimës së thirrur si dëshmitar
5	Mosnjoftimi i palëve në kohë për mbajtjen e seancës gjyqësore
6	Seancat gjyqësore fillojnë me vonesë

6.3 Karakteristikat e rasteve të dhunës në familje sipas të dhënave të monitorimit


Bazuar në 448 seanca gjyqësore të monitoruara në rastet e dhunës në familje, të dhënat tregojnë se në 50% të rasteve lloji më i shpeshtë i dhunës së ushtruar brenda marrëdhënies familjare ishte dhuna fizike (228 nga 448), e ndjekur nga dhuna psikologjike në 42% të rasteve (168 nga 448). Rastet e mbetura përfshinin një kombinim të këtyre dy llojeve të dhunës, si dhe dhunë seksuale ose ekonomike.

Grafiku 19. Llojet e dhunës së ushtruar nga monitorimet e gjykatës




Në shumicën e rasteve të monitoruara (89%), dhuna është ushtruar vetëm nga një person që ishte në marrëdhënie familjare me viktimën, ndërsa rastet e mbetura përfshinin dy ose më shumë persona të akuzuar që ushtronin dhunë ndaj një anëtari të familjes. Lidhur me numrin e viktimave, monitorimi zbuloi se në 377 nga 448 seanca dëgjimore, vetëm një person ishte palë e dëmtuar, ndërsa në rastet e tjera, midis dy dhe katër persona kishin statusin e viktimave të dhunës në familje.

Në rastet e monitoruara nga Just React gjatë periudhës maj-dhjetor 2025, kishte 494 persona të akuzuar për dhunë në familje, nga të cilët 430 ishin burra dhe 64 ishin gra. Prandaj, këto të dhëna tregojnë se rreth 87% e të akuzuarve për dhunë në familje ishin burra, ndërsa 13% ishin gra.

Grafiku 20. Raporti midis burrave dhe grave të akuzuar nga monitorimet e gjykatave

Një tjetër karakteristikë e nxjerrë nga monitorimi i seancave gjyqësore është raporti gjinor midis viktimave të dhunës në familje. Të dhënat tregojnë se nga 528 viktima, 98 ishin burra, ndërsa 397 ishin gra. Kështu, këto të dhëna tregojnë se afërsisht tre nga katër, ose 75% e viktimave të dhunës në familje janë gra.

Grafiku 21. Raporti midis viktimave burra dhe gra nga monitorimi i gjykatave

Lidhur me marrëdhënien familjare ndërmjet të akuzuarit dhe viktimës, të dhënat e monitorimit tregojnë se mbizotërojnë rastet që përfshijnë bashkëshortë (181), marrëdhënie prind-fëmijë (90), persona të divorcuar (54), persona në marrëdhënie jashtëmartesore (42) dhe marrëdhënie të tjera familjare (si vëlla-vëlla, motër-motër, fëmijë-prind, etj.).

Tabela 9. Marrëdhënia familjare midis të akuzuarit dhe viktimave nga monitorimi i gjykatave

Marrëdhënia familjare	Number of cases
Bashkëshortët	181
Marrëdhëniet prind-fëmijë	90
Personat e divorcuar	54
Personat në marrëdhënie jashtëmartesore	42
Marrëdhënie të tjera familjare (p.sh. vëlla-vëlla, motër-motër, fëmijë-prind, etj.)	

7. Gjetjet dhe Rekomandimet

Kosova ka një kornizë ligjore të konsoliduar në lidhje me parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, mbrojtjen e viktimave dhe masat ndëshkuese kundër personave që kryejnë këtë veprë penale. Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve Kufizohet me Vendime Gjyqësore nuk po gjen zbatim të duhur. Që nga miratimi i tij në vitin 2015, u deshën 9 vjet për të filluar zbatimin e tij dhe është ende në fazën fillestare. Institucionet përgjegjëse duhet të përqendrohen në zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi dhe të synojnë avancimin e mëtejshëm të këtij legjislacioni duke penalizuar dhunën në internet dhe femicidin.

Në vitin 2025, Policia e Kosovës regjistroi 2,815 raste të dhunës në familje, që korrespondojnë me një shkallë prej 17.6 rastesh për 10,000 banorë. Këto raste përfshinin 2,836 viktima, 2,998 të dyshuar dhe rezultuan në 1,081 persona të arrestuar. Në vitin 2025, Prokuroritë Themelore pranuan 2,453 kallëzime penale për dhunë në familje dhe ngriten 1,901 aktakuza, duke rezultuar në një shkallë të përgjithshme aktakuzash prej 77.5%. Koha e zgjidhjes së lëndëve nga ndjekja penale është 38.4 ditë. Ekziston një mospërputhje e qartë midis rasteve të raportuara në polici, kallëzimeve penale në prokurori dhe aktakuzave.

Nga të dhënat e ofruara nga KGJK-ja, rezultoi se në vitin 2025, gjykatat themelore kanë pranuar 1007 raste të dhunës në familje, nga të cilat 568 janë zgjidhur, ndërsa 439 raste mbeten të pazgjidhura. Shkalla e Zgjidhjes së rasteve të trajtuara nga gjykatat themelore sipas të dhënave të KGJK-së është 56%, ndërsa Koha e Zgjidhjes që u duhet gjykatave për të zgjidhur një rast të dhunës në familje është 281 ditë. Në bazën e të dhënave të KGJK-së mungojnë elemente të rëndësishme të të dhënave, siç është ndarja sipas gjinisë dhe moshës si të viktimave ashtu edhe të të pandehurve, marrëdhëniet familjare, statusi ekonomik ose lloji i dhunës në familje të shkaktuar.

Në 87% të rasteve të zgjidhura, gjykatat kanë shpallur dënime, ndërsa vetëm në 1/3 e tyre të pandehurit janë dënuar me dënim efektiv. 85% e të pandehurve kanë pranuar fajësinë për veprën penale të dhunës në familje.

Sfidat në monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave gjyqësore për dhunën në familje, mospublikimi i vendimeve dhe mungesa e disa treguesve në bazën e të dhënave të KGJK-së, ngrenë shqetësime në lidhje me mungesën e transparencës dhe rrezikun e moszbatimit ose zbatimit joadekuat të politikave që synojnë rritjen e efikasitetit të trajtimit të këtyre rasteve. Gjatë monitorimit të efikasitetit të gjykatave dhe menaxhimit të të dhënave nuk po shfrytëzohen plotësisht të dhënat shtetërore në dispozicion, prandaj nuk ka lidhje midis Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Lëndëve dhe bazës së të dhënave shtetërore.

Just React monitoroi 830 seanca gjyqësore në kuadër të gjykatave themelore, nga të cilat 448 ishin me natyrë dhune në familje, ndërsa 382 seanca të tjera ishin me elemente të dhunës me bazë gjinore ose veprave të tjera penale që lidhen me këtë element. Nga 830 seanca të monitoruara, 260 prej tyre u shtynë për shkak se nuk u përmbushën kushtet ligjore për mbajtjen e tyre. Arsyeja kryesore për shtyrjen e seancave gjyqësore ishte mungesa e palëve.

Shkeljet procedurale dhe mangësitë e tjera që karakterizuan seancat gjyqësore të monitoruara janë: regjistrimi jo i saktë i rrjedhës procedurale në procesverbal; mosaktimi i një avokati sipas detyrës zyrtare për të pandehurin pavarësisht kërkesës nga pala; mosdhënia e shkresave të lëndës për palët nga prokurori i shtetit dhe rastet e mbajtjes së seancave gjyqësore pa përmbushur këtë detyrim ligjor; nivel jo i kënaqshëm i trajtimit të viktimës së thirrur si dëshmitare;

mosnjoftimi me kohë i palëve për mbajtjen e seancës gjyqësore; fillimi i vonshëm i seancave gjyqësore, etj. Prandaj, është përgjegjësi e Gjykatës, Prokurorisë dhe Avokatëve të kontribuojnë në procedurat gjyqësore efikase dhe efektive në mbrojtjen e të drejtave të palëve të përfshira.

Lloji më i shpeshtë i dhunës së përdorur nga të akuzuarit në lidhje me viktimat është dhuna fizike, ndërsa në shumicën e rasteve ka vetëm një person të akuzuar për dhunë në familje. Sa i përket gjinisë, 87% e të akuzuarve janë burra, ndërsa 75% e viktimave të dhunës në familje janë gra. Dhuna në familje ndodhë më shpesh në marrëdhënien midis bashkëshortëve, e ndjekur nga marrëdhëniet prind-fëmijë, personat e divorcuar, etj.

Bazuar në gjetjet e mësipërme, jepen rekomandimet e mëposhtme për institucionet që merren me rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore:

- Ministria e Drejtësisë duhet të propozojë avancimin ose përditësimin e legjisllacionit që penalizon dhunën online ndaj grave në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës/Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë duhet të marrin masa për të siguruar zbatimin e plotë të Ligjit Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve është e Kufizuar me Vendim Gjyqësor, i cili është në fuqi që nga viti 2015.
- Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Lëndëve që përdoret nga gjykatat duhet të përdoret dhe të integrohet në mënyrë më efektive me bazën e të dhënave shtetërore për të siguruar një menaxhim më të mirë të të dhënave dhe koordinim institucional.
- Raportet e policisë duhet të jenë më gjithëpërfshirëse dhe të detajuara në mënyrë që ta lehtësojnë aftësinë e Prokurorisë për t'i vlerësuar provat dhe për të inicuar aktakuzat në mënyrë më efektive.
- KGJK-ja duhet të përfshijë në bazën e saj të të dhënave të dhëna që ofrojnë të dhëna mbi gjininë e të pandehurve dhe viktimave, marrëdhënien e tyre familjare, gjendjen ekonomike, dënimin total të shqiptuar, kohëzgjatjen nga pranimi deri në zgjidhjen e lëndës, llojin e dhunës në familje që është shkaktuar, grupmoshën e të pandehurve dhe viktimave, etj.
- Gjykatat duhet ta rrisin efikasitetin kohor të trajtimit të çështjeve dhe të zbatojnë një politikë ndëshkuese sipas legjisllacionit në fuqi ndaj të dënuarve për dhunë në familje, duke aplikuar dënime me burgim dhe gjobë;
- Gjyqtarët duhet të marrin masa për të siguruar praninë e palëve në seancat gjyqësore, duke zvogëluar kështu numrin e seancave të shtyra;
- Gjyqtarët duhet të menaxhojnë në mënyrë më efikase dhe të respektojnë dispozitat e procedurës penale gjatë seancave gjyqësore, duke minimizuar rastet kur seancat gjyqësore dështojnë për shkak të mosnjoftimit të palëve në kohë ose pa u siguruar që palëve t'u ofrohen shkresat e lëndës;
- Prokurorët duhet të shmangin rastet e mungesave në seancat gjyqësore dhe t'u japin palëve shkresat e lëndës në kohën e duhur;
- Avokatët e të akuzuarve për dhunë në familje duhet t'i japin përparësi përfaqësimit të këtyre rasteve, duke minimizuar praktikën e anulimit të seancave dëgjimore për shkak të mungesës së tyre.



Funded by
the European Union

Performanca dhe Mangësitë: Trajtimi Institucional i Dhunës në Familje në 2025

Mars 2026



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE